



Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova

Kosovo Chamber of Physiotherapists

KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE I OFTK-së, në mbështetje të nenit 8, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1. dhe 1.2, nenit 51 të Rregullorës për Zgjedhjet e Organeve të OFTK-së nr 1020 të datës 20.12.2022 në mbledhjen e mbajtur me date 29.01.2025 mori këtë:

V E N D I M

- I. **HAPJEN E AFATIT** të periudhës së kandidimit për 2 anëtarë të Këshillit Drejtues të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës.
- II. Periudha e kandidimit hapet nga ora: 08:00 data 14.02.2025 deri me 20.02.2025 ora:16:00.
- III. Kandidati/ja duhet të jetë anëtarë/e e Kuvendit të OFTK-së – Legjislatura e III-të.
- IV. Kandidati duhet të ketë nënshkrime mbështetëse e të paktën 5 anëtarëve të Kuvendit të OFTK-së – Legjislatura e III-të.
- V. Kandidati/ja për anëtarë/e nga paragrafi i I-rë nuk mund të jetë anëtarë në organet e tjera të OFTK-së.
- VI. Kandidati/ja për anëtarë të Këshillit Drejtues të OFTK-së nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.
- VII. Kandidati/ja për anëtarë/e nga organi i përcaktuara nga paragrafi I-rë, nuk mund të jap nënshkrim mbështetës për kandidaturën e tij dhe as për ndonjë kandidatë tjetër.
- VIII. Një anëtarë/e i/e Kuvendit të OFTK-së nuk mund të jap nënshkrime mbështetëse më shumë se një kandidatë për të njejtin organ.
- IX. Kandidati/ja pajiset me fletaplikacion për kandidim të aprovuar nga KQZ në zyret e Sekretariatit të KQZ-së.
- X. Aplikacionet dorëzohen në zyret e Sekretariatit të KQZ-së brenda afatit të paraparë në pikën II të këtij vendimi.
- XI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimit i bashkëlidhet Fletaplikacioni për kandidim për anëtarë të Këshillit Drejtues të OFTK-së të aprovuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor i OFTK-së

I'dërgohet :

- Anëtarëve të Kuvendit
- Sekretariatit të KQZ-së

Kryetari i KQZ-së
Prof.Asoc.Dr. **Milazim Gjocaj** MD, MSc. PhD

Adresa: Kompleksi i QKUK-së - Instituti A (Instituti i Anatomisë), Kati i III-të, RKS-10000 Prishtinë
Address: UCKK Complex - Institute A (Institute of Anatomy), 3rd Floor, RKS-10000 Prishtina
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; ëëb : ëëë.oftk-ks.org

Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës

